

AKTI I THEMELIMIT I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“LATERN3” Sh.p.k.

Neni 1

Ortaku themelues

Sot me date 10 Nentor 2021 ortaket themelues:

Z.Klevi Allgjata i biri i Zijait, shtetas Shqiptar, lindur ne Tirane, Tirane, me 30.08.1994 , me nr.karte identiteti J40830063A dhe banues ne Tirane, me adrese rruga Pavaresia, Nd. 19; H.1

Z.Alfons Pjetri i biri i Feritit, shtetas Shqiptar, lindur ne Librazhd me 01.09.1995 , me nr.karte identiteti J50901027B dhe banues ne Prrenjas, me adrese Fshati Fanje, Nd. 043; H.0; Ap.0; Qukes; Fanje; 3407; Prrenjas

Z.Enerik Kapllanaj i biri i Kristaqit, shtetas Shqiptar, lindur ne Cakran, Fier, me 15.09.1994 , me nr.karte identiteti J40915022H dhe banues ne Fier, me adrese Cakran; Buzmadh; Nd 085; 9311

Themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar si me poshte vijon:

Neni 2

Emertimi

2.1 Shoqeria emertohet **“LATERN3” sh.p.k.**

Neni 3

Forma dhe baza ligjore

3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.), ne baze te ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me Vendim te Asamblese se Ortakut/eve te shoqerise.

3.3 Shoqeria **“LATERN3” sh.p.k.**, do te kryej veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, me statutin, me ligjin Nr. 9901, date 14.4.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar.

Neni 4

Kohezgjatja

- 4.1 Veprimtaria e Shoqerise do te filloje pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit te Tiranes. Veprimtaria e shoqerise do te zgjase per nje periudhe kohe te pacaktuar.

Neni 5

Selia

- 5.1 Selia e shoqerise eshte Rruga "Bulevardi Zogu i Pare", Hyrja 2, Apartamenti 43, Tirane.
Shoqeria ka te drejte te krijojë dege, filiale ose/dhe zyra perfaqesimi ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Objekti

- 6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqerisë është :

Ofrimi i shërbimeve inxhinierike si projektim dhe konsulence.
Diagnostifikim i problemeve teknike industriale dhe zgjidhja e tyre.
Ofrimi i shërbimit të instalimeve elektrike dhe elektronike të pajisjeve industriale.
Projektimi dhe dizënjimi i manualeve dhe dokumentacioneve teknike shoqeruese për prodhimin e pjesëve mekanike, elektrike dhe elektronike.
Dizënjim i grafikëve dhe gjenerim i imazheve 3D.
Krijimi i animacioneve dhe videove informuese mbi produkte të ndryshme komerciale.
Shërbime të montimit të pajisjeve industriale.

- 6.2 Objekti i Shoqerisë mund të zgjerohet ose ndryshojë me vendim të asambleës së ortakëve të shoqerisë.

Neni 7

Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerisë është i perbere nga 100 000 leke nga të cilat :

- | | |
|-----------------------|---|
| 1- Z.Klevi Allgjata | 1- kuote e barabarte me 33.33 % te kapitalit. |
| 2- Z.Alfons Pjetri | 1- kuote e barabarte me 33.33 % te kapitalit. |
| 3- Z.Enerik Kapllanaj | 1- kuote e barabarte me 33.33 % te kapitalit. |

Neni 8

Vendimet e Asamblese se Ortakut/ve te Shoqerise. Administrimi

- 8.1 Vendimet kryesore merren nga Asambleja e Ortakut/eve te shoqerise.
- 8.2 Shoqeria do te administrohet nga nje administrator qe do te jete **Z. Klevis Allgjata me afat 5 -vjecar.**

Neni 9

Eksperti kontabel i autorizuar

- 9.1 Eksperti (ekspertet) kontabel i (te) autorizuar do te caktohen me vendim te marre nga Asambleja e Ortakeve te shoqeris ne rast se do te permbushen kushtet e percaktuara nga ligji.

Neni 10

Viti financiar

- 10.1 Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Si perjashtim, viti i pare i veprimtarise se shoqerise do te filloje nga dita e regjistrimit te Shoqerise prane organeve tatimore dhe perfundon me 31 Dhjetor 2019.

Neni 11

Pasqyrat financiare. Mbajtja e kontabilitetit

- 11.1 Pasqyrat financiare vjetor te Shoqerise miratohen nga Asambleja e Ortakut/eve te shoqerise, nenshkruhen nga administartori i shoqeris dhe i paraqitet organeve te percaktuara deri ne fund te muajit maj te vitit pasardhes.
- 11.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen shqipe dhe ne monedhen shqiptare. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute, te cilat do te konvertohen ne monedhe shqiptare.

Neni 12

Te ardhurat. Dividenti

- 12.1 Shoqeria do te krijojte fonde rezerve per realizimin e objektit te saj.

12.2 Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo viti financiar, pas mbulimit te shpenzimeve dhe pagimit te tatimeve, mund te ndahen si dividend Ortakut /eve te shoqerise.

Neni 13

Likuidimi

13.1 Shoqeria do te hyje ne procesin e likujdimit nese:

- Gjendja ekonomike ne Shqiperi nuk do te lejoje vazhdimin e veprimtarise se shoqerise;
- Asambleja e ortakut/ve te shoqerise vendos te prishe shoqerine.

13.2 Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likujdimit, Asambleja e Ortakut/eve te shoqerise emeron nje likuidator ose nje grup likuidatoresh.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarreshjeve

14.1 Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen per zgjidhje Gjykates se Tiranes.


Neni 15

Klauzola mbyltese


15.1 Ky akt themelimi hartohet ne 5 ekzemplare, ne gjuhen shqipe, secili me vlere te njejte ligjore.

Ortaket e Shoqerise

Z. Klevi Allgjata



Z. Alfons Pjetri



Z. Enerik Kapllanaj

